



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

(Specialist)

LLOJI I DIPLOMËS “ INXHINERI NDERTIMI”

NIVELI MINIMAL I DIPLOMËS “DIPLOME E NIVELIT TE PARE”

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicionëve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhetë Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Roskovec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit nëshërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- ❖ 1(nje) Specialist Inxhinier ndertimi Bashkia Roskovec

Shpallja eshte e hapur per te gjithë nepunesit civil te se njejtës kategori ne te gjitha institucionet pjese e shërbimit civil. Nese nuk ka nje fitues nga procedura e levizjes paralele, plotesimi i vendit vakant do te realizohet me procedurën e Pranimit në shërbimin Civil. Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe Praniminë Shërbimin Civilnë kategorineekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

LEVIZJE PARALELE: 02 Qeshor 2017

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 07 Qeshor 2017

Përshkrim i Përgjithshëm

Specialisti përgjigjet para Përgjegjësit të Sektorit të Projektimit për menaxhimin e çështjeve që lidhen me fushën e veprimtarisë së sektorit në përputhje me ligjet, aktet nënligjore apo aktet rregullatore në fuqi.

DETYRAT

Detyrat Kryesore

- *Llogarit volume të punimeve sipas projekteve;*
- *Aplikon çmimet sipas llojit të punimeve dhe analizon çmime të reja (kur mungojnë në manual);*
- *Llogarit mbikëqyrjet dhe kolaudimet sipas vlerave të preventivave;*
- *Mbikqyr dhe kontrollon funksionimin Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit për Bashkinë, inventarit elektronik dhe shkresor i cili ruhet, mirëmbahet, administrohet dhe përditësohet në mënyrë të pavarur.*
- *Përpilon kthim e përgjigjeve kundrejt subjekteve të ndryshme private apo shtetërore në lidhje me kërkesat e tyre për të drejtën e informacionit;*
- *Kryen inspektimin e situatës në terren për të gjitha shqyrtimet e aplikimeve, për leje punimesh dhe jep sugjerime për zgjidhje në kohë sa më të shkurtër, nëse ka problem;*
- *Verifikon në terren kërkesat e ankesat e ardhura në adresë të Drejtorisë dhe përgatit përgjigjet për këto probleme;*
- *Përgatit informacione të detajuara teknike në lidhje me kontrollin e zbatimit të lejeve të punimeve;*
- *Identifikon problematikat e rezultuara gjatë kontrolleve dhe harton brenda afateve të përcaktuara njoftimet zyrtare për subjektet ndërtuese në rastet kur realizimi i punimeve, nuk rezulton në përputhje me kushtet e lejes së dhënë;*
- *kontrollon afatet e përfundimit të punimeve për subjektet që janë drejt përfundimit të afatit të lejes së punimeve*

I. Levizja Paralele

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunëscivil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.

2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kriteret e vecanta per kete pozicion jane:

- a) te zoteroje diplome minimumi 3-vjecare ,Diplomë “Bachelor”, në Degët e Inxhinierise se Ndertimit. Nese diploma eshte marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- b) te kete te pakten 1 vit punë.
- c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorise Juridike dhe te Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovecs, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje e vleresimit të fundit vjetor.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë **02.06.2017**

Rezultatet nga verifikimi paraprak te kushteve minimale te procedures se levizjes paralele dhe te permbushjes se kriterëve specifike te vendit te punes do te dalin ne daten **05.06.2017** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin ”Sherbimi Kombëtar i Punesimit”, në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit te publikut.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit te Burimeve Njërëzore, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.

Ankesat nga kandidatet paraqiten ne Njësine e Menaxhimit te Burimeve Njërëzore, brenda **3 diteve** kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr pergjigje **brenda 5 diteve** kalendarike nga data e paraqitjes të saj.

Intervista me goje do te zhvillohet ne ambjentet e Bashkise Roskovec me datë

16.06.2017 ora 10:00

Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

- Ligji nr.139/2015 “Per vetqeverisjen Vendore’
- Ligji 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar nga ligji nr. nr. 73/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 “për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar nga ligji nr. ligjin Nr. 9200, datë 26.02.2004, ligji nr. 9794, datë 23.07.2007, ligji nr. 9826, datë 01.11.2007, ligji nr. 10 137, datë 11.05.2009, ligji nr. 10 324 datë 23.09.2010, ligji nr. 11/2012 datë 09.02.2012 dhe ligji nr. 20/2013 datë 14.2.2013;
- Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar me ligjin nr. 10240, datë 25.02.2010, ligji nr. 23/2013 datë 14.2.2013 dhe ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014;

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:Kandidatet do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshem për Lëvizjen Paralelel ngritur nëBashkine Roskovec**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për çertifikimin pozitiv.
- b. **60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohet parashikimi i pikës 13, të Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242 dt.18.03.2015 ‘Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese’

Komisioni në dt.**17.06.2017** njofton për vendimin e përzgjedhjes, Njesine Pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njërëzore.

Njesia Pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njërëzore me date **19.06.2017**shpall fituesin.

Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkise dhe ne stenden e publikimeve te Bashkisë Roskovec.

II- Pranimi në Shërbimin Civil.

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vendit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë e kzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotrojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar(hequr) sipas këtij ligji.

Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:

- a) te zoteroje diplome minimumi 3-vjecare , Diplomë “Bachelor”, në Degët e ,Inxhinierise Ndertimit. Nese diploma eshte marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- b) te kete te pakten 1 vit punë.
- c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovec këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës.Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave.Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë **07.06.2017**

Rezultatet nga verifikimi paraprak te kushteve minimale te procedures e pranimit në shërbimin civil dhe te permbushjes se kriterëve specifike te vendit te punes do te dalin ne daten **12.06.2017** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, ne portalin ”Sherbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Gjithashtu, po në këtë datë kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerezore për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten ne Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezore, Informacionit dhe Marrdhënieve me Publikun, brenda **5 diteve**kalendarike nga dhe ankuesi merr pergjigje brenda **3 diteve** pune nga data e depozitimit te saj.

Konkurimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me goje,do te zhvillohet ne ambjentet e Bashkise Roskovec në datën **21.06.2017 ora 10⁰⁰**.

Në konkurimin me shkrim dhe intervistë e strukturuar me goje, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 ‘Per vetqeverisjen Vendore’
- Ligji 107/2014, ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’ i ndryshuar nga ligji nr. nr. 73/2015 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 ‘për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 ‘Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit’, i ndryshuar nga ligji nr. ligjin Nr. 9200, datë 26.02.2004,
- ligji nr. 9794, datë 23.07.2007, ligji nr. 9826, datë 01.11.2007, ligji nr. 10 137, datë 11.05.2009, ligji nr. 10 324 datë 23.09.2010,
- ligji nr. 11/2012 datë 09.02.2012 dhe ligji nr. 20/2013 datë 14.2.2013;
- Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 ‘Për inspektimin e ndërtimit’ i ndryshuar me ligjin nr. 10240, datë 25.02.2010, ligji nr. 23/2013 datë 14.2.2013 dhe ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014;

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkise Roskovec.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim;

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin "Specialist Inxhinier Ndertimi".

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 ‘Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorin ekzekutive’.

Komiteti i Përhershëm i Pranimibrënda 24 (njëzet e katër) orëve, pra në **dt.22.06.2017** njofton listen e fituesve, Njesise pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Njesia pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njerezore më date **22.06.2017**, shpall listen e fituesve.

Njoftimi do të bëhet: në portalin ‘Shërbimi Kombëtar i Punësimit’ ,në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec dhe ne stenden e informimit publik.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne adresen Bashkia Roskovec.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : evisa.mustafaj@yahoo.com

nr.tel: **0387 80242.**

NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

BASHKIA ROSKOVEC